

# Tax Alert Albania

March 2023



**pwc**

# PwC Albania - Tax Alert

## Decision no.113, date 1.3.2023 "For determining the minimum salary on a national level"

Starting from 1 April 2023, the minimum monthly salary for employees nationwide, which is mandatory to be applied by any person, legal or physical, local or foreign, will be 40,000 (forty thousand) ALL, (for 174 working hours per month). The maximum salary, for the purpose of calculation of social security contributions, will be ALL 176,416.

The minimum hourly base salary will be 229.9 (two hundred and twenty nine point nine) ALL, and permanent allowances are given on top of the base salary.

Source: Official Gazette no. 34, dated 2.3.2023 ([Link](#))

## Law no. 15/2023 "On the ratification of the agreement between the Council of Ministers of the Republic of Albania and the Government of the Republic of Finland for the elimination of double taxation, in relation to income taxes and the prevention and avoidance of tax evasion."

The agreement between the Council of Ministers of the Republic of Albania and the government of the Republic of Finland on the elimination of double taxation, in relation to income taxes and the prevention and avoidance of tax evasion, is ratified.

This law enters into force 15 days after its publication in the Official Gazette.

Source: Official Gazette no. 32, dated 28.02.2023 ([Link](#))

## Notice no. 1659, dated 7.2.2023 "On the entry into force of an international agreement"

Decision of the Joint Committee of the Central European Free Trade Agreement no. 1/2021, approved on June 21, 2021, which amends annex 4 of the Central European Free Trade Agreement (CEFTA 2006), which defines the protocol regarding the definition of the concept of "originating products" and the methods of administrative cooperation, entered into force on February 1, 2023

Source: Official Gazette no. 21, dated 9.2.2023 ([Link](#))

## Vendim nr. 113, dt. 1.3.2023 "Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi"

Nga data 1 prill 2023, paga bazë minimale mujore për punonjësit në shkallë vendi, që është e detyrueshme të zbatohet nga çdo person, juridik a fizik, vendas ose i huaj, do të jetë 40 000 (dyzet mijë) lekë (për 174 orë pune në muaj). Paga maksimale, për efekt të llogaritjes së kontributeve të sigurimeve shoqërore do të jetë 176,416 lekë.

Paga bazë minimale orare do të jetë 229,9 (dyqind e njëzet e nëntë pikë nëntë) lekë, dhe shtesat me karakter të përhershëm jepen mbi pagën bazë.

Burimi: Fletorja zyrtare nr. 34, dt 2.3.2023 ([Link](#))

## Ligj nr. 15/2023 "Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Finlandës për eliminimin e tatimit të dyfishtë, në lidhje me tatimet mbi të ardhurat dhe parandalimin e shmangien e evazionit tatimor."

Ratifikohet marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Finlandës për eliminimin e tatimit të dyfishtë, në lidhje me tatimet mbi të ardhurat dhe parandalimin e shmangien e evazionit tatimor.

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Burimi: Fletorja Zyrtare nr. 32, dt.28.02.2023 ([Link](#))

## Njoftim nr. 1659, datë 7.2.2023 "Mbi hyrjen në fuqi të një marrëveshje ndërkombetare",

Vendimi i Komitetit të Përbashkët të marrëveshjes së Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore nr.1/2021, miratuar më 21 qershor 2021, që ndryshon aneksin 4 të Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore (CEFTA 2006), që përcakton protokollin në lidhje me përkufizimin e konceptit të "Produkteve origjinuese" dhe metodat e bashkëpunimit administrativ, ka hyrë në fuqi më 1 shkurt 2023

Burimi: Fletorja Zyrtare nr. 21, dt. 9.2.2023 ([Link](#))



# Let's talk!

For further information, please contact:

PricewaterhouseCoopers Albania  
Str. "Ibrahim Rugova", Sky Tower, 9/1

Telephone: +355 4 22 90 700

Email: [al\\_pwc\\_albania@pwc.com](mailto:al_pwc_albania@pwc.com)

Web: [www.pwc.com/al](http://www.pwc.com/al)

